

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

Tiranë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

*Ndërmjet:*

**Mazars, Tiranë**, me adresë rruga Rr Emin Duraku, Pall. Binjaket n°5 Tirana, Albania përfaqësohet nga Z. Teit Gjini, partner në menaxhim.

*Dhe*

**Universiteti Barleti (UniBa)** Institucion i Arsimit të Lartë, me adresë në rr. Frang Bardhi, Nr. 118, Tiranë, përfaqësuar nga Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë Prof. Assoc. Dr. Mateo Spaho.

### Neni 1

#### Qëllimi dhe Objekti

1. Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit mes institucioneve firmëtare, duke përcaktuar detyrimet e secilës palë.
2. Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe angazhime reciproke në aplikimin e zbatimin dhe nismave në sektorët e mëposhtëm:
  - a. Pjesëmarrje në leksione, konferenca dhe aktivitete të tjera të fushës;
  - b. Organizimi dhe mediatizimi i aktiviteteve të përbashkëta;
  - c. Pjesëmarrja në praktikat mësimore dhe trajnuese te studenteve të UMB.

### Neni 2

#### Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga përfaqësuesit e të dyja palëve.

### Neni 3

#### Informacion mbi palët

**Mazars** është një organizatë ndërkombëtare, e integruar dhe e pavarur e specializuar në shërbimet e auditimit, kontabilitetit, taksave, ligjore dhe këshillimore. Mazars Group është një lider në tregun



Faqe 1 nga 3



evropian në fushën e tij. Partnerët e Mazars në Shqipëri janë Kontabilistë Publikë të Certifikuar (CPA) në Shqipëri dhe Kosovë me më shumë se 25 vjet përvojë të suksesshme profesionale.

## Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve

### **Mazars Albania:**

- a. Mazars angazhohet të jetë partner i qëndrueshëm i palëve në marrëveshje në aplikimet e ndryshme në kuadër të programeve të ndryshme të financuara nga donatorë kombëtarë apo ndërkombëtarë;
- b. Mazars do të kërkojë ekspertizë në fushën që institucioni partner mbulon, në përputhje me kërkesat dhe kriteret për një ekspertizë të caktuar siç është trajnime dhe shërbime të tjera në fushën e auditimit, kontabilitetit, taksimit;
- c. Mazars do të punojë së bashku me partnerët përmes nismave të përbashkëta, duke ngritur grupe pune;
- d. Mazars shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave.
- e. Personi i kontaktit do të jetë: z. Teit Gjini me adresë e-mail: [teit.gjini@mazats.al](mailto:teit.gjini@mazats.al).

### **Universiteti BARLETI (në vijim UniBa):**

- a. UniBa angazhohet në bashkëpunim me partnerët, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektivit të kësaj marrëveshje.
- b. UniBa angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në projekte, trajnime, seminare, forume, konferenca, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimiti etj.;
- c. UniBa angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut palëve në marrëveshje, duke vënë në dispozicion stafin e saj akademik në përputhje me ekspertizën e kërkuar nga projekti/ iniciativa.
- d. Personi i kontaktit do të jetë dr. Edvin Stefani me adresës e-mail; [e.stefani@umb.edu.al](mailto:e.stefani@umb.edu.al)

### **Palët bashkërisht bien dakord si vijon:**

- a. Të punojnë së bashku në drejtim të hartimit të projekt propozimeve në fushat e përbashkëta të interesit;
- b. Të jenë në kontakt për çdo thirrje të mundshme dhe mundësi bashkëpunimi në partneritet;
- c. Të zbatojnë programet dhe projektet e përbashkëta me interes publik si dhe shkëmbimin e informacionit e dokumentacionit, i cili do të përdoret vetëm për qëllime të realizimit të projekteve;
- d. Të bashkëpunojnë në çdo fushë tjetër të pa listuar më sipër, brenda objektivit të tyre dhe për të cilët palët kanë kapacitetet e përshtatshme profesionale.

## Neni 5 Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve firmëtare, të shprehur në një dokument të shkruar.
2. Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njëri prej partnerëve, çon detyrimisht në prishjen e saj. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga partneri, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi.




# mazars



3. Kjo marrëveshje përmban 3 (tre) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje origjinale me të njëjtën vlerë.

Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord:

**Mazars Albania**  
**Partner në menaxhim**  
Teit Gjini



**Universiteti Barleti**  
**Dekan**  
Prof. Assoc. Dr. Mateo Spaho

